



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Smart Eng Group Sh.P.K." të datës 23.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Smart Eng Group Sh.P.K." të datës 23.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Smart Eng Group Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 23.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA-së - Gëlqerosja" me nr. të prokurimit 616-25-5454-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

## Pretendimet ankimore të parashtruesit:

### Pretendimi ankimore 1.

Pas publikimit të vendimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit, me datën 18.07.2025, ne si operator ekonomik, pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, dhe palë me interes juridik siç përcaktohet me nenin 4.1.26, të LPP-se, kemi kërkuar qasje në dokumente – ofertën e OE të propozuar për dhënie të kontratës dhe ofertat tjera pjesëmarrëse të kualifikuara si të përgjegjshme por të pa suksesshme, si rrjedhojë me datën 22.05.2025, na është lejuar qasja dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar në oferta ka rezultuar që kompanitë e kualifikuara si të përgjegjshme nga ju si AK- Komuna prishtine, janë tërësisht të pa përgjegjshme në raport me kërkesat kualifikuese, përderisa oferta jone tentohet të eliminohet kunderligjshëm.

Në leter standarde të datës 18.07.2025, ndaj ofertës sonë juve si AK si arsyetim të eliminimit keni potencuar:

*"Grupi i OE-ve "Smart Eng Group & Co, nuk ka ofruar dëshmi dokumentare mbi posedimin e aftësive teknike dhe profesionale, kërkesa nr. 3. Që ka të bëjë me vërtetimin e resurseve e veta njerëzore ka stafin profesional dhe stafin teknik (punonjes) që do të kryejnë projektin 15, punonjes ku 10 nga ta duhet të jenë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Punëtor teknik me përgoditje të mesme shkollore: Një teknik të ndërtimeve, një*

*teknik të arkitektures, një teknik hidrondertimtare, një teknik të makinerisë, punëtor të certifikuar 2 elektro instalues, një shtatues, një shelist, një kranist, operator me vine, një punëtor për vjesjellës dhe kanalizim, një zërkthtar për mobileri dhe një punëtor për shtrurjen e qeramikeve, një fasader, një punëtor për punë në lartësi, një murator dhe një latues"*

Ky arsyetim i eliminimit të kompanisë sonë fare nuk ka të bëjë me gjendjen faktike të ofertës sonë dhe si i tillë është vetëm tentativa për eliminimin e ofertës sonë përkatësisht lidhjen e kontratës me kompani e cila ka ofertuar me çmim më të lartë se sa grupi i OE-ve ankues. AK – Komuna Prishtinë, përkatësisht komisioni vlerësues i ofertave sipas arsyetimit të eliminimit të përshkruar në leter standarde nuk ka dhënë arsye konkrete se cila kërkesë nuk është plotësuar dhe cila e bën ofertën tonë si të pa përgjegjshme.

Në si Grupi i OE-ve ne oferte kemi prezantuar të gjitha provat dhe dëshmitë me të cilat e kemi plotësuar secilin kërkesë të AK-se sa i përket stafit kyq dhe stafit mbështetës, kualifikimet profesionale, certifikimet përvojën dhe numrin e tyre.

Grupi i OE-ve ankues, në oferte në kuadër të stafit profesional dhe stafit mbështetës ka prezantuar gjithsej 27 të punësuarve, për të cilët janë prezantuar, kontratat, parakontratat dhe të gjitha dëshmitë tjera me të cilat plotësohet në tërësi kërkesa kualifikuese, si rrjedhojë e kësaj komisioni vlerësues i ofertave me rastin e eliminimit të grupit të OE-ve ankues ka shkelur në tërësi dispozitat e nenit 59, të LPP-se, pasi që nuk ka realizuar, vlerësim, ekzaminim dhe krahasim të ofertave siç përcaktohet me paragrafin 4 të të njëjtit nenin, si rrjedhojë e kësaj me vlerësimin e tillë të njëanshëm dhe subjektiv komisioni vlerësues, secili anëtar veq e veq, sipas paragrafit 1, barte përgjegjësi për vlerësimin e ofertave, dhe tentativa për lidhjen e kontratës me oferte të pa përgjegjshme dhe e cila permante çmimin gati trefishi më të lartë se sa e ofertës sonë, tregon për shkelje të parimeve bazike të prokurimit publik dhe është e sanksionuar edhe me nenin 97, të Rregullores me nr. 001/2022, për Prokurim Publik.

Dëshmit tjerë të kerkuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë ndaj stafit bashkangjitur si tërësi i gjeni në platformën e-prokurimi, si rrjedhojë ndaj stafit kyq dhe stafit teknik juve si AK – Komuna Prishtinë tek kërkesat kualifikuese që kanë të bëjnë me piken 3, të kapacitetit teknik dhe profesional keni kërkuar:

*Kërkesa 3 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se në resurset e veta njerëzore ka stafin ndihmës profesional Stafi teknik (PUNONJES) që do të kyçet në projekt minimumi 15 punonjës, min 10 prej tyre të jenë të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në punë. Punëtor Teknik me përgatitje të mesme shkollë - Një teknik të ndërtimtarisë - Një teknik të arkitekturës - Një Teknik hidrondërtimtar, - Një Teknik të makinerisë, Punëtor të certifikuar - Dy Elektroinstalues - Një Suvatues - Një Skelist - Një Kranist - Operator në vinç - Një punëtor për Ujësjellës dhe kanalizim - Një Zdrukthëtar për Mobilieri - Një punëtor për shtruarjen e geramikave - Një Fasader - Një punëtor për punë në lartësi - Një Murator - Një Latues*

Dëshmia dokumentare.

*Evidenca 3 -Listën e punëtorëve të OE, e njëjta duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. - Për punëtor teknik me përgatitje të mesme shkollë duhet të dorëzohen -Kopjet e diplomave të shkollave të mesme profesionale të akredituara nga institucione shtetërore. -Për punëtor të certifikuar duhet të dorëzohen - Kopjet e certifikatave të trajnimit të lëshura nga institucione apo trupa certifikues të akredituara. Min për 10 prej*

*Punëtorëve Teknik me përgatitje të mesme shkollë dhe Punëtor të certifikuar duhet të dorëzohen kopjet e certifikatave për Siguri dhe Shëndet në punë.*

Grupi i OE-ve ankues sipas listës së stafit të prezantuar si më sipër, përkatësisht sipas dokumentacionit të ngarkuar në ofertë, rezultoi që ka prezantuar të gjitha dëshmitë lidhur me stafin kyq dhe stafin përgjegjës.

#### Preteudmi ankimorë 2

Juve si AK – Komuna Prishtinë – Komisioni vlerësues i ofertave për këtë procedurë të prokurimit haptazi keni shkelur parimet bazike të prokurimit, publik, keni shkelur deklaratat tuaja nën betim dhe haptazi keni faforizuar kompaninë e cila ka ofertuar me çmimin rreth 3 fishi më të lartë se sa oferta jonë, madje kompani kjo e pa përgjegjëshmëri në aspekt administrativ, teknik dhe financiar.

OE i propozuar për dhënie të kontratës sipas qasjes në ofertën e tij rezultoi se i njëjti nuk ka prezantuar në ofertë shkruesat – dokumentet ndaj kërkesave kualifikuese.

Në dosje të tenderit në pikën 7.1 & 7.2, tek kërkesat e pershtatshmerisë profesionale është kërkuar:

*4. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për materialet e perdorura në pozicionet 5.2 dhe 5.7 të paramasës dhe parallogaritë"*

Paramasa dhe parallogaria për këto pozicione përmbanë produktet: "Amstrong" dhe "Hidroizolim me gjeomembranë". Ju si AK, ndaj këtyre produkteve keni kërkuar autorizim të prodhuesit të produkteve si rrjedhojë OE i propozuar për dhënie të kontratës në ofertë

nuk ka prezantuar autorizimin e prodhuesit të këtyre dy produkteve, si rrjedhojë marrëveshja e prezantuar në ofertën e OE të propozuar për dhënie të kontratës nuk e plotëson kërkesën kualifikuese të përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Me nenin 59, par 4 të LPP-se kjo tërësi përcaktohet që AK, mund dhe duhet ta kualifikojë si të përgjegjshme ofertën e cila i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në formën siç kërkohej në FDT. OE i propozuar për dhënie detyrësisht ka qenë dashur të eliminohet si i pa përgjegjshëm, përkatësisht lidhja eventuale e kontratës me kompani të tilla dhe me çmim të tilla që në keqpërdorim dhe abuzim me parane publike dhe dispozitat ligjore.

### **Pretendimi ankimore 3**

Operatori ekonomik i propozuar për dhenien e kontratës në oferte nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me referencat për punë të realizuara në projekte paraprake të natyrës së njëjtë ashtu siç është përcaktuar në piken 2, të kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional:

*2.1 Një menaxher i projektit..., 10 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme.*

*Minimumi të këtë menaxhuar tri projekte:*

Dëshmia dokumentare e kërkuar:

*2.1 - Kopje të diplomës, -- Kopje të Certifikatës për menaxhim të kantierit; -Kopje të certifikatës së trajnimit për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri; -Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vetë ing.; -Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; -Referencat për menaxhimin e projekteve.*

OE i propozuar për dhenien e kontratës, ndaj menaxherit të kontratës në oferte nuk ka prezantuar kurrëfarë dëshmie lidhur me përvojën profesionale, përkatësisht menaxhimin e projekteve ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Sipas qasjes në ofertën e të nevojtes kompani rezultoi që projekt menaxheri i prezantuar, ka menaxhuar projekte lidhur me menaxhimin e rrugëve dhe urave, përderisa lidhur me menaxhimin e objekteve shkollore, gelqerorje apo renovim të objekteve nuk ka prezantuar kurrëfarë dëshmie.

Për më tepër, sipas listës së stafit OE i propozuar për dhenien e kontratës anëtarit të grupit OE "Olti Trasing", në oferte ka bashkangjitur kontratën për punë primare me menaxherinë projektit, ku sipas kushteve kontraktuale menaxheri është i deklaruar me punë primare me pagë, në nivelin e pages minimale në Republikën e Kosovës, me orare të plote, përkatësisht, 40 ore për javë apo 8 ore në ditë, dhe se sipas verifikimit online në ATK, tek rubrika e tatim paguesit, rezultoi që projekt menaxheri i prezantuar në ofertën e OE të propozuar për dhenien e kontratës është i deklaruar me punë primare tek kompania "Famis," përderisa "Olti Trasing" e ka të deklaruar me punë sekondare.

### **Pretendimi ankimore 4**

Operatori ekonomik i propozuar për dhenien e kontratës është i pa përgjegjshëm edhe ndaj kërkesave tjera përkatësisht nuk ka prezantuar "Mikser betoni për përgaditjen e betonit" dhe në oferte nuk ka prezantuar as planin dinamik ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Ju ve si AK, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional në piken 5 përveq tjerash keni kërkuar:

- "dy mikser betoni për përgaditjen e betonit" OE në oferte ka prezantuar dëshmi vetëm për një mikser për përzierjen e betonit përderisa ju si AK në kërkesë kualifikuese keni kërkuar dy të tilla.

Grupi i OE-ve të propozuar për dhenien e kontratës ka qenë dashur të eliminohet si i pa përgjegjshëm edhe për faktin se në oferte nuk ka prezantuar planin dinamik për realizimin e punëve përkatësisht në piken 5.2 të FDT-së është përcaktuar:

- "Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 60 ditë kalendarike"

Ndaj kësaj kërkesë OE i propozuar për dhenien e kontratës në oferte nuk ka prezantuar kurrëfarë dëshmie lidhur me afatet e përfundimit të kontratës.

### **Pretendimi ankimore 5**

Ju ve si AK –Koman-Prishtinë, keni kualifikuar si të përgjegjshëm edhe ofertën e OE "Nika Proing" shpk, pavarësisht faktit se e njëjta oferte është në tërësi e pa përgjegjshëm në raport me kërkesat kualifikuese, përkatësisht e njëjta oferte nuk ka argumentuar se posedon Autorizim të prodhuesit për pozicionet 5.2 dhe 5.7, të paramases dhe parallogaritjes ashtu siç është kërkuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Ngjashëm qëndron fakti edhe për menaxherinë kontratës dhe inxhinierin e hidroteknikës, të njëjtë nuk kanë prezantuar certifikatën për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri të cilat janë pa validitet,

përkatësisht certifikatën për menaxhim të kantierit nuk e disponon fare, si rrjedhojë oferta e njëjtë ka qenë dashur të eliminohet si e pa përgjegjshme.

Ndaj kërkesës, tjetër lidhur me menaxherinë punishtes OE i njëjtë ka prezantuar certifikatë për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri pa validitet dhe si të tilla bien ndesh me kërkesën kualifikuese të përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional.

OE "Nika Proing" shpk, është i pa përgjegjshëm edhe ndaj kërkesave tjera lidhur me stafin mbështetës ku në oferte i njëjti nuk ka prezantuar kurrëfarë dëshmie lidhur me kërkesën "Punëtorin për punë në Lartësi" dhe nuk është prezantuar as plani dinamik i punëve ashtu siç është përcaktuar në piken 5.2, të FDT-së, ku është përcaktuar afati kohor për fillimin dhe përfundimin e punëve prej 60 ditësh.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Grupi i Operatorëve Ekonomik SMART ENG GROUP SH.P.K.; BAJRAM HA.GASHI B.I.; TONI O.P. nuk ka ofruar dëshmi dokumentare mbi posedimin e aftësive teknike /profesionale- Kërkesa nr.3 që ka të bëjë me; Kërkesa 3 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se në resurset e veta njerëzore ka stafin ndihmës profesional Stafin teknik (PUNONJËS) që do të kryejnë në projekt minimumi 15 punonjës, min 10 prej tyre të jenë të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në punë. Punëtor Teknik me përgatitje të mesme shkollë - Një teknik të ndërtimitarisë - Një teknik të arkitekturës - Një Teknik hidrondërtimtar, - Një Teknik të makinerisë, Punëtor të certifikuar - Dy Elektroinstalues - Një Suvatues - Një Skelist - Një Kranist - Operator në vinç - Një punëtor për Ujësjellës dhe kanalizim - Një Zdrurthëtar për Mobilieri - Një punëtor për shtruarjen e qeramikave - Një Fasader - Një punëtor për punë në lartësi - Një Murator - Një Latues.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi dokumentare lidhur me kërkesën nr. 3 të DT sikurse evidentohet në letrën standarde për eliminimin e tij. Në fakt parashtruesi në parim nuk i konteston arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij pasi që thotë se e ka dorëzuar listën e stafit mirëpo në rastin konkret nuk është kontestuese lista e stafit por dëshmitë dokumentare sipas kërkesës përkatëse në DT. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe kërkesat për pajisjet, autorizimet, stafin. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.07.2025

  
Visar SHEHU  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.